

# Akt Thmelimi

I shoqerise tregtare "Pitagora Serramenti" shpk.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikës se Shqipërisë , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Për sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismës se lire dhe te veprimtarisëprivate dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqëritë tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Për Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nënshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortaket:

-**Antonio Matija** i biri i Kel dhe i Veronike dtl 31.05. 1987 lindur e banues ne Shkoder

-**Leonard Matija** i biri i Kel dhe i Veronike dtl 06.03. 1974 lindur e banues ne Shkoder

Sot me date 29.08.2022, krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Pitagora Serramenti" shpk me akt themelimi si vijon :

## **Formulimi**

### **Neni 1**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "Pitagora Serramenti" shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

## **Selia e Shoqerise**

### **Neni 2**

Shoqeria e ka adresen ne rruga Agron, Shkoder, me numer objekti 18/697, zona kadastrale 8591. Nese ne te ardhmen gjate aktivitetit lind nevoja e ndryshimit te adreses, nuk eshte e nevojshme te ndryshohet edhe statuti i shoqerise.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetëm me vendim te asamblesë dhe ortakut te vetëm .

## **Objektivi i Veprimtarise**

### **Neni 3**

Shoqeria "Pitagora Serramenti" shpk do te kete si objekt :

-Prodhim i artikujve duralumin, plastike, alumin/druri, xhami, konstruksione metalike e te ngjashme si produkte te gatshme, gjysem te gatshme, si dhe aksesore per keto prodhime, duke filluar nga elementet me te thjeshte e deri tek ndertimet me keto materiale si komplekse turistike, shtepi, njesi tregtare etj te ngjashme. Prodhime dhe montime me materiale te porositesit si dhe me materialet tona.

Prodhim, montim, tregtim me shumice e pakice Import Eksport, i artikujve te ndryshem dyer dritare, vetrata me alumin, pvc, drurit, duralumini, punime mekanike te gjitha llojeve, prodhim dhe tregtim te produkteve te xhamit alumin xhami, profileve llamarinet, hekurit.

Prodhim dhe tregtim me shumice e pakice import eksport te grilave te te gjitha llojeve . Ndertim dhe tregtim te godinave familjare dhe tregtare, transport per llogari te te treteve. Prodhimin dhe shitblerjen e

artikujve te ndryshem import eksport te Artikujve te prodhuara nga shoqeria.  
Si dhe çdo operacion tjetër që bashkohet me veprimtarite e mesiperme e që konsiderohet i pershtatshem e me leverdi për rritjen e zhvillimin e metejshem të aktivitetit të shoqerise.

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

### Neni 4

Shoqeria " **Pitagora Serramenti** " shpk krijohet për të ushtruar veprimtarine e saj për një kohezgjatje mbi 10 vjet.

Shoqeria " **Pitagora Serramenti** " shpk mund të zgjase afatin e veprimtarise se saj ose mund ta mbylle aktivitetin e saj para këtij afati, sipas dispozitave që përcaktohen në këte statut dhe sipas kritereve që përcaktohen nga legjislati në fuqi.

## Kapitali i Shoqerise

### Neni 5

Ortakët vendosen që Kapitali Themeltar i shoqerise "**Pitagora Serramenti**" do të jetë 4.000. 000. (kater milion) leke dhe derdhja e kapitalit do të bëhet sipas ligjit të shoqerive tregtare.

I ndare ky kapital në 2 kuota. Ky Kapital themeltar zotërohet nga ortakët e shoqerise në masën 49% (ose 1.960.000 lek) ortakë Antonio Matija, 51% (ose 2.040.000 lek) ortakë Leonard Matija.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tyre janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve ashtu dhe përkundërt personave të tretë.

Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmone me miratim të ortakëve dhe akt noterial.

Në qoftë se njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotën e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablërjes nga ortakët e tjerë, ose aprovimin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij një subjekti tjetër.

Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga një ekspert kompetent i caktuar nga ortakët

## Drejtimi i Shoqërisë

### Neni 6

Organi më i lartë vendimor i shoqerise është Asambleja e Ortakëve .

Në asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas kuotave përkatëse.

Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Miraton bilancin vjetor të shoqerise.
- Vendos për shtimin, pakesimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emeron dhe revokon Administratorin e shoqerise.
- Emeron dhe revokon Ekspertin kontabel të Shoqerise.
- Kryen modifikime në statut sipas ecurive të shoqerise si dhe kontroll të shoqerise.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shndërrimin e saj në një tip tjetër shoqerie.

Administratori i shoqerise perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet dhe ka te gjitha kompenat per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise.

Shoqeria merr persiper te gjitha pergjegjesite qe mund te vijne nga veprimet e kryera nga administratori. Administratori ka afat maksimumi 5-vjet dhe afati eshte i detyrueshem te parashikohet ne aktet e shoqerise.

**Z. Antonio Matija eshte perfaqesues ligjor dhe Administrator i shoqerise.**

#### Neni 7

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me kuotat e tyre takuese ne kapitalin themeltar

#### Neni 8

Ortaket kane te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve .

-Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare te shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe Statutin.

-Te kerkojne dhe t'u jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria (bilanci, libra llogarie).

-Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblese se Shoqerise.

-Te heqin dore nga shoqeria ne kushtet qe percaktohen ne kontrate dhe ne statut.

#### Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Shkoder.



### **Neni 10**

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj.

### **Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem .

### **ORTAKET SHOQERISE**

*Antonio Matija*



*Leonard Matija*

